




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.390/2023
Datë: 31 gusht 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 105 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.12, nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 34 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, si dhe nenit 67 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, në mbledhjen 314-të, të mbajtur me datë 31 gusht 2023 merr këtë:

V E N D I M

- I. Z. Gani Avdiu, gjyqtar në Gjykatën e Apelit, propozohet tek Presidentja e Republikës së Kosovës, për lirim nga detyra e gjyqtarit, për shkak të përfundimit të mandatit, me arritjen e moshës së pensionimit me datë 14 shtator 2023.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 31 gusht 2023.


A r s y e t i m

Konform nenit 34 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, gjyqtarit Gani Avdiu, sipas fuqisë ligjore i përfundon mandati i gjyqtarit, pasi që i njëjti me datë 14 shtator 2023, arrin moshën e pensionimit prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç.

KGJK, bazuar në nenin 26 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i propozon Presidentes së Republikës së Kosovës Sh.S.Znj. Vjosa Osmani – Sadriu, të liroj nga detyra gjyqtarin Gani Avdiu.

Nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Qerim Ademaj



Zëvendës Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe
- Arkivit.